

PROCESVERBAL
nga seanca e 36-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 19.09.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm edhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga shërbimi profesional: Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Magdalena Davidovska Dovleva, Ivana Stojanovska, Maja Damevska.

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski hapi seancën e 36-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi rendin e ditës:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 12-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 12.09.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 35-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 12.09.2024.
3. Propozim-vendim për refuzim të Kërkesës për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit digjital tokësor.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga z. Fidanoski e miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 12-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 12.09.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 5 vota “pro” dhe një abstenim nga z. Fidanoski miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 35-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 12.09. 2024, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për refuzim të Kërkesa për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit digjital tokësor. Ai shpjegoi se me kërkesë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI SHPKNJP Shtip, është përgatitur Studim për të përcaktuar arsyetimin e shpalljes së konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit digjital tokësor dhe në pajtim me gjetjet nga Studimi, i cili është përgatitur nga operator ekonomik, Agjencia ka refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i Kërkesës ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative, e cila ka pranuar padinë dhe ka dhënë udhëzime për përgatitjen e një Studimi të ri, por kësaj radhe të përgatitet nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele pa pjesëmarrjen e operatori të jashtëm ekonomik. Këshilli i Agjencisë për përgatitjen e dokumentit dha afat prej 60 ditësh, nga ku Agjencia në afatin e përcaktuar, i cili përfundon më 16.09.2024, ta përgatisë dhe publikon në ueb-faqen e Agjencisë. Konkluzioni i Studimit është se nuk ka arsyetim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes në përputhje me Kërkesën e parashtruesit.

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr.Magdalena Davidovska Dovleva, shpjegoi se Studimi metodologjikisht është i strukturuar në atë mënyrë që do të jetë në gjendje t'i përgjigjet qëllimit për të cilin po përgatitet, veçanërisht nga aspekti i rregullatori të medias, i cili gjatë përgatitjes së këtij lloji Studimi, duhet para së gjithash të marrë parasysh qëllimet kryesore të politikës mediatike, që është ofrimi i diversitetit dhe përmbajtjes cilësore për publikun. Prandaj, nuk ishte e mundur të qëndrohet vetëm në analizën ekonomike, por Studimi përfshin edhe aspektin e diversitetit të ofertës ekzistuese mediatike, si dhe qëndrimet dhe preferencat e publikut. Ajo theksoi se pjesa e parë e Studimit, analiza ekonomike, vërtetoi atë që deri më tani është përsëritur shumë herë nga ekspertë të ndryshëm të veprimtarisë, se tregu mediatik maqedonas ka pak potencial ekonomik, me burime të kufizuara reklamuese, por edhe se numri i subjekteve është mjaft i madh që të mund të flitet për ndonjë qëndrueshmëri dhe zhvillim të tregut. Është bërë dhe një analizë krahasuese me vendet e rajonit dhe si shembull ka thënë se në Serbi tregu është gjashtë herë më i madh dhe ata kanë 4 televizione, ndërsa ne kemi 5, tregu Bullgar është katër herë më i madh dhe ata kanë 3 televizione. Edhe pse numri i televizioneve në Maqedoni është i madh, ende mungon diversiteti. Shumica e televizioneve, 38 nga gjithsej 39 televizione transmetojnë formate programore të formatit të përgjithshëm dhe të 5 televizionet në nivel shtetëror kanë leje të transmetojnë shërbim programor të njëjtë, me format të përgjithshëm me funksion kryesisht argëtues. Si rregullator janë marrë parasysh këto çështje dhe shembull i mirë është Kroacia, vend me një treg mediatik shumë më të zhvilluar, në nivel shtetëror ka vetëm 2 televizione të formatit të përgjithshëm dhe 5 të tjerat janë të specializuara, për fëmijë, për përmbajtje sportive, muzikore dhe argëtuese. Është një shembull i mirë që duhet ta zbatojmë. Pjesa e tretë është analiza e nevojave dhe qëndrimeve të publikut, gjatë së cilës nuk është kryer ndonjë hulumtim i ri, sepse janë shfrytëzuar të dhënat nga hulumtimet e mëparshme të

realizuara në gusht 2023. Konkluzioni i hulumtimit është se publiku beson se nuk janë të përfaqësuar sa duhet emisionet dokumentare, programet edukative, programet në fushën e artit dhe kulturës, programet sportive, programet për fëmijë dhe filmat vizatimorë dhe në të njëjtën kohë nuk janë të kënaqur me cilësinë e programeve ekzistuese. Pikërisht këto përmbajtje programore janë më të ndjekurat ndër kanalet e huaja. Kur pyeten se cilat kanale të huaja shikojnë më shpesh, publiku zakonisht tregon kanale të specializuara filmike, sportive, dokumentare, për fëmijë. Detyra e Agjencisë, si rregullator i medias, është që publikut t'i sigurojë që televizionet vendase t'i ofrojnë këto përmbajtje. Prandaj, gjetjet e Studimit tregojnë se nuk ka justifikim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetimin televiziv në nivel shtetëror për format të përgjithshëm me funksion kryesisht argëtues ose me funksion kryesisht informativ, as dhe format të përgjithshëm në të cilin janë të tre funksionet e medias janë të përfaqësuar, sepse ajo që nevojitet janë shërbime të specializuara programore.

Z. Ajdini tha se studimi është punuar shkëlqyeshëm, ka parë të gjitha të dhënat, si dhe krahasimin e bërë me vendet e rajonit. Ai deklaroi se është plotësisht dakort me konkluzionet dhe konstatimet dhe beson se nuk do të ketë as justifikim dhe as qëndrueshmëri nëse i jepet leja televizionit me format të përgjithshëm, kryesisht argëtues. Në këtë drejtim, ai tha se do të votojë për refuzimin e Kërkesës.

Z. Trajçev tha se është mirë të kemi konkurrencë, ai theksoi se edhe herën e kaluar është mirë të zgjerohet oferta, por gjithashtu nuk është aq ekspert që të mund ta vlerësojë. Ai beson se Agjencia dhe shërbimi profesional Studimin e kanë punuar në mënyrë shumë profesionale dhe cilësore. Ai theksoi se në LSHMAAV ka dispoziv, që është neni 70 paragrafi (7), i cili thotë se "...nëse studimi konstaton se nuk ka arsytim për shpalljen e konkursit publik, Agjencia në afat prej 8 ditësh nga dita publikimit të Studimit do të marrë Vendim për refuzimin e Kërkesës...". Ai shpjegoi se Këshilli është i të obliguar që të veprojnë në përputhje me Studimin dhe ta refuzojnë Kërkesën, gjegjësisht Këshilli të mbështesë Vendimin e propozuar nga Agjencia.

Z. Fidanoski në fillim të diskutimit deklaroi se do të votojë "pro" propozimit. Ai beson se Studimi është përgatitur jashtëzakonisht profesionalisht, në detaje dhe saktësisht për të gjitha kriteret dhe konstatimet që i nevojiten Këshillit për të marrë vendimin që duhet të jetë. Edhe pse në shifra absolute në pjesën ekonomike produkti i brendshëm bruto mund të jetë rritur në krahasim me disa vite më parë, në realitet flukset ekonomike nuk janë të mira, ka krizë ekonomike, rritje të inflacionit lidhur me krizën Covid, luftën në Ukrainë, dhe se rritja e inflacionit kërkon ulje serioze të fuqisë blerëse të qytetarëve dhe që praktikisht e thënë me fjalë popullore "ka pak më pak para në xhepat e tyre". Aspekti i dytë është tregu i reduktuar mediatik, që është evident edhe në kuptimin financiar, dhe fatkeqësisht, deri në një ditë të bukur, e thënë figurativisht, bëhemi interesantë për ndonjë media të madhe me lojtar të huaj, tregu ynë do të jetë i kufizuar kryesisht për shkak të pengesës gjuhësore që nuk lejon rritje të madhe në atë treg mediatik. Për këto arsye, tregu mediatik, ashtu siç është, nuk ofron mundësi për të rritur numrin e lojtarëve që do të mund të punojnë me fitim. Në fund të fundit, shifrat dhe treguesit që aplikohen individualisht për vetë transmetuesit në pjesën më të madhe thonë se disa prej tyre kanë punuar negativisht në aspektin financiar, gjë që tregon se është kushtimisht problematik nga aspekti i qëndrueshmërisë së biznesit. Pjesa e tretë është nevoja për formate të specializuara programore, këtë udhëheqësja Magdalena e shpjegoi bukur, është absolutisht e nevojshme ky auditor audiovizual në Maqedoni për ndryshim, një rifreskim i ri, një format tjetër, një format i specializuar, i cili do të sjellë diversitet më të madh në peizazhin

mediatik. Në Studim kushtimisht thuhet se cilat fusha janë më interesantet, pra filmi, pjesë e fushës sportive, të cilat tërheqin pjesën më të madhe të publikut nga jashtë, kushtimisht thënë nga këta transmetues tokësorë që kanë përgjithësisht format të përgjithshëm argëtues. Për këto arsye, në këtë moment, edhe pse në parim është përkrahës i faktit se është mirë, siç tha z. Trajçev, të ketë më shumë konkurrencë, në këtë moment mendon se nuk ka kushte për hapjen e konkursit për dhënien e lejes.

Z. Petrushevski tha se studimi vërteton atë që në njëfarë mënyre të gjithë e shohin dhe ndjejnë, e kjo është se në pesë vitet e fundit nuk ka ndonjë përparim të madh të gjendjes ekonomike në shtet dhe mediave, kështu që tregu është i kufizuar kështu që asgjë nuk ka ndryshuar nga vitet e kaluara, dhe ajo që është shumë e rëndësishme, që edhe kolegu Fidanoski tha, është se mundësia për televizion të ri mund të ekzistojë vetëm me format tjetër. Pra, kjo duhet të jetë këshillë për aplikuesit e ardhshëm, jo vetëm për aplikantin aktual, sepse nuk është kufizim kush mund të paraqesë aplikim, dhe gjithashtu nuk do të thotë se në konkurs do të fitojë ai që ka aplikuar, sepse ky është konkurs i hapur publik. Shpjegoi se këto janë dy aspektet që do të kontribuojnë të voton për propozimin për refuzimin e kësaj kërkesë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim që refuzon Kërkesën me shkrim të palës së interesuar, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI SHPKNJP Shtip ark.nr. 03-24/1, datë 13.01.2022 (nr ynë PA1.08-13 datë 20.01.2022) për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv të shërbimit programor me format të përgjithshëm kryesisht informativ ose me format të përgjithshëm me tre funksionet mediatike (informative, edukative dhe argëtuese), në nivel shtetëror, nëpërmjet multipleks digjital tokësor, për arsye se me Studimin për përcaktimin e arsytimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor (ark.nr.03-3766/1 datë 19.09.2024), u konstatua se nuk ka arsytim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror për: 1. Shërbime programore të formatit të përgjithshëm me funksion kryesisht argëtues, 2. Shërbime programore të formatit të përgjithshëm me funksion kryesisht informativ dhe 3. Shërbime programore në të cilat llojet e programeve të përfaqësuara realizojnë tre funksionet mediatike.

Z. Petrushevski, pas votimit, uroi që ekonomia të shkojë më mirë dhe të ketë sërish kandidatë të interesuar për hapjen e konkursit publik, ndoshta dhe i njëjti aplikant, por duhet të jetë me një format tjetër.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**